



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.168/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës se Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, kunder debitorit “Queen Massage 3” shpk, me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.1374/23 të datës 25.10.2023, me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Queen Massage 3” shpk, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.1374/23 të datës 25.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1374/23 të datës 25.10.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “Queen Massage 3” shpk, me seli ne Prishtinë dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.141/23 te datës 03.08.2023, te lejuar nga përmbaruesi privat Isak Islami, si dhe ka përfunduar procedurën përmbarimore

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta prish dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rivendosje .

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 03.08.2023, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarues Vendimit nr.01.25-32/2023 te dtaes 28.10.2022 me të cilën është detyruar debitori “Queen Massage 3” shpk, me seli ne Prishtinë që kreditorit në emër të ndëshkimit administrativ për shkeljen e nenit 17 par.2 të Ligjit të Punës e sanksionuar me nenin 92 të Ligjit të Punës, bazuar në nenin 7 par.2 pika 2.7 të UA. Nr.07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës, t’ia paguaj shumën prej 500.00 EUR e pesëqind euro) € si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifatat në fuqi..

Kundër urdhrit përbarimor debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke njoftuar se ka paguar gjoben e cila ka sherbyer si titull përbarimor, pra ka permbuhur ne teresi detyrimin e kerkuar. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar.

Pala kreditor, ka ushtruar pergjigje ne prapesim duke theksuar se tek perms prapesimit eshte njoftuar per pagesen e bere nga ana e debitorit, andaj ka propozuar qe te vazhdohet procedura dhe te detyrohet debitorit e beje pagesen e shpenzimeve te procedures perbarimore.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar duke qene se i njejt i ka permbushur detyrimin e percaktuar ne propozim. Andaj ne kuptim te nenit 71 par.1, pika 1.2 te LPP si dhe nenit 12 te Ligjit per Ndryshimin dhe Plotesimin e Ligjit, ka marre vendim si ne dispozitiv te aktvendimit te atakuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përbaruesit privat, me të cilin është caktuar përbarimi i propozuar nga kreditori.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar se vendimi i Gjykates se shkalles se parë eshte marre ne tërësi ne përputhje me nenin 71 par.1, pika 1.2 te LPP si dhe nenit 12 te Ligjit per Ndryshimin dhe Plotesimin e Ligjit, ka marre vendim si ne dispozitiv te aktvendimit te atakuar.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk II.nr.168/24 me datë 05.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami